

L I G J
Nr. 8944, datë 19.9.2002

PËR PRODHIMIN, EMËRTIMIN DHE TREGTIMIN E VAJIT TË ULLIRIT
(Ndryshuar me ligjin nr. Nr.9863, datë 28.1.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të vendosë rregullat për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit në Republikën e Shqipërisë, që ai t'u përshtatet kërkesave dhe standardeve të tregut ndërkombëtar, dhe të sigurojë prodhimin dhe tregtimin me origjinë dhe cilësi të kontrolluar.

Neni 2
Përkufizime

1. "Vaj ulliri i virgjër" është vaji i ullirit, i cili përftohet nga ullinjtë (*Olea Europea L*), vetëm nëpërmjet proceseve mekanike dhe fizike, si larja, presimi, centrifugimi, dekantimi dhe filtrimi. Nga ky përkufizim përjashtohen vajrat e përfutuara nga tretësit ose me procese të riesterifikimit dhe të çdo përzierjeje me vajra me natyrë të ndryshme nga ai i ullirit.

Klasifikimi i këtij lloj vaji përcaktohet si më poshtë:

a) "Vaj ulliri i virgjër i cilësisë së lartë" është vaji i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 1 gram për 100 gram.

b) "Vaj ulliri i virgjër" është vaji i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 2 gram për 100 gram.

c) "Vaj ulliri i virgjër i zakonshëm" është vaji i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 3,3 gram për 100 gram.

ç) "Vaj ulliri i virgjër ndriçues" është vaji i ullirit i virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është më shumë se 3,3 gram për 100 gram. Ky vaj nuk lejohet për konsum njerëzor.

2. "Vaj ulliri i rafinuar" është vaji i ullirit i përftuar nga rafinimi i vajit të ullirit të virgjër, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 0,5 gram për 100 gram.

3. "Vaj ulliri" është vaji i ullirit i përftuar nga një përzierje e vajit të ullirit të rafinuar dhe të vajit të ullirit të virgjër pa vajin e ullirit të virgjër ndriçues, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 1,5 gram për 100 gram.

4. "Vaj i bërsisë së ullirit i papërpunuar" është vaji i ullirit, i përftuar nga trajtimi me tretës të bërsisë së ullirit, i cili nuk përmban vajra të përfutuara nga proceset e riesterifikimit ose të çdo lloj përzierjeje me vajra me natyrë tjetër nga ai i ullirit. Ky vaj nuk lejohet për konsum

njerëzor.

5. “Vaj i bërsisë së ullirit i rafinuar” është vaji i përftuar nga rafinimi i vajit të bërsisë së ullirit, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 0,5 gram për 100 gram.

6. “Vaj i bërsisë së ullirit” është vaji i përftuar nga një përzierje e vajit të bërsisë së ullirit të rafinuar dhe të vajrave të ullirit të virgjëra, pa vajin e ullirit të virgjër ndriçues, në të cilin aciditeti i lirë, i shprehur në acid oleik, është jo më shumë se 1,5 gram për 100 gram.

KREU II PRODHIMI DHE TREGTIMI I VAJIT TË ULLIRIT

Neni 3 **Subjektet prodhuese**

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari në prodhimin dhe tregtimin e vajit të ullirit, i nënshtrohen kërkesave të këtij ligji.

2. Vaji i ullirit prodhohet nga persona fizikë dhe juridikë të pajisur, detyrimisht, me lejet tekniko-teknologjike dhe profesionale, të përcaktuara në ligjin nr. 7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin”.

Neni 4 **Karakteristikat e vajrave të ullirit**

Cilësia dhe kriteret e natyrshmërisë të të gjitha vajrave të ullirit, të emërtuara dhe të përkufizuara në nenin 2 të këtij ligji, si dhe karakteristikat organo-shqisore dhe fiziko-kimike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5 **Rregullat e tregtimit**

Tregtimi i vajrave të ullirit, të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji, bëhet sipas rregullave të mëposhtme:

a) Të gjitha vajrat e ullirit të përkufizuara sipas nenit 2 tregtohen të ambalazhuara. Ato lejohen të tregtohen në gjendje të hapur, vetëm nga prodhuesi, deri te subjektet ambalazhuese.

b) Marketimi i vajit të ullirit bëhet në përputhje me rregullat për marketimin e produkteve ushqimore të përcaktuara në ligjin nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin” dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 6 **Kufizime dhe detyrime**

1. Ndalohen ruajtja dhe tregtimi i vajit të ullirit të virgjër të cilësisë së lartë, të vajit të ullirit të virgjër dhe të vajit të ullirit të virgjër të zakonshëm në fabrikat e rafinimit.

2. Kur në të njëjtën fabrikë, përveç impianteve të rafinimit ka edhe linja ambalazhimi për vajrat e ullirit të virgjëra, është e detyrueshme ruajtja e këtyre vajrave në enë të numëruara dhe mbajtja e regjistrave të hyrje-daljeve, ku shënohen çdo ditë lëvizjet dhe prejardhja përkatëse e këtyre produkteve. Këto procedura përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 7
Mbrojtja e emërimit të origjinës

1. Përcaktimi dhe emërtimi i origjinës i zonës me ullishta bëhen me akt nënligjor të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

2. Vaji i ullirit i virgjër merr emërtimin e origjinës, në përputhje me ligjin nr. 7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”.

KREU III
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 8
Përcaktimi i kundërvajtjeve administrative

Sipas këtij ligji, në rastet kur nuk përbëjnë vepër penale, trajtohen si kundërvajtje administrative, shkeljet e dispozitave që kanë të bëjnë me:

a) mosrespektimin e natyrshmërisë së vajrave të ullirit nga përzierja e tyre me vajrat e tjera, të ndryshme nga vaji i ullirit, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji;

b) mosrespektimin e karakteristikave të vajrave të ullirit, në kundërshtim me nenin 2 dhe që kalojnë kufijtë e parashikuar në aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave;

c) prodhimin e vajit të ullirit pa lejet përkatëse të parashikuara në nenin 3;

ç) mosrespektimin e kërkesave të ambalazhimit, marketimit dhe reklamës së vajit të ullirit të virgjër të cilësisë së lartë, vajit të ullirit të virgjër dhe të vajit të ullirit në kundërshtim me shkronjën b të nenit 5 të këtij ligji;

d) mosrespektimin e rregullave në fabrikat e rafinimit të vajrave të ullirit, në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji;

dh) mosrespektimin e kërkesave të emërimit të origjinës, në kundërshtim me nenin 7 dhe aktin nënligjor të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 9
Sanksionet

1. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, nga organet e kontrollit ndërmerren sanksionet si më poshtë:

a) për shkeljet e parashikuara në pikën 3 masa e gjobës është nga 40 mijë deri në 50 mijë lekë;

b) për shkeljet e parashikuara në pikën 2, masa e gjobës është nga 150 mijë deri në 200 mijë lekë;

c) për shkeljet e parashikuara në pikat 1, 4, 5 dhe 6 masa e gjobës është nga 400 mijë deri në 500 mijë lekë.

2. Sipas rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, malli bllokohet dhe bëhet rivlerësimi i tij, sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10
Organet kompetente për vendosjen e masave administrative
(Shfuqizuar me ligjin nr. Nr.9863, datë 28.1.2008)

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 11
Heqja nga qarkullimi

Vajrat e ambalazhuara që janë në treg, të cilat nuk janë në përputhje me nenin 4, hiqen nga qarkullimi brenda 3 muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 12
Përcaktime të tjera

Rregullat për prodhimin, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit organik përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 13
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse në zbatim të neneve 4, 6, 7 dhe 9 të këtij ligji.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3502, datë 16.10.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**